



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

17 Dhjetor 2015



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Ramadani: Kartat shëndetësore deri në fund të vitit



Qytetarët presin kartat shëndetësore prej muajsh, dhe për të cilat kanë paguar më herët, do t'i marrin ato në fund të këtij viti. Drejtori i Fondit Shëndetësor Orhan Ramadani shpjegoi se për momentin po shtypen rreth 95 mijë karte shëndetësore. Vonesën e tillë Ramadani e shpjegoi me probleme sistemore dhe teknike.

Ndërsa disa qytetarë do të marrin kartat e tyre shëndetësore për herë të parë, për 46 mijë të tjerët kartat duhet të ripërpunohen, për shkak të skadimit të afatit të tyre prej 5 vitesh. Ata duhet të paguajnë përsëri nga 100 deri në 250 denarë, varësisht kategorisë në të cilën bëjnë pjesë.

Kartelat vazhdon t'i përpunojë kompania kroate që fitoi tenderin që prej fillimit. Nga Fondi i Shëndetësisë mohojnë se lëshimi i kartave elektronike ka lidhje me fushatën parazgjedhore. Autoritetet shpjegojnë se krahas kartave, do të përdoren përsëri edhe librezat e vjetra shëndetësore. Kartat janë të nevojshme për qytetarët që të shkojnë te mjeku pa kartonët e kaltër, ndërsa të dhënat e tjera mjekësore në librezë do të vazhdojnë të jenë të nevojshme.

Legalizohet ligji për përdorimin e prodhimeve nga kanabisi për qëllime mjeksore



Ministria e shëndetësisë përgatiti propozim-ligj për legalizimin e përdorimit të prodhimeve nga kanabisi për qëllime mjekësore.

Pritet që Ligji të hyjë në fuqi nga muaji shkurt.

Sipas propozim-ligjit kanabisi do të mund të prodhohet dhe përdoret vetëm në Maqedoni dhe atë do të mund ta prodhojnë



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



vetëm persona juridik.

Sipas ministrit të shëndetësisë Nikolla Todorov propozim-ligji do të dërgohet në procedurë qeveritare, ndërsa këtë të diel do të organizohet debat publik që të dëgjohen propozimet dhe vërejtjet plotësuese në drejtim të përmirësimit të këtij vendimi.

Në BE deri më tani 13 vende anëtare mundësuan përdorimin e kanabisit për qëllime mjekësore.



Maqedonia e legalizon kanabisin!



Maqedonia ka filluar procedurën për legalizimin e marihuanës për qëllime mjekësore.

Më së voni deri në shkurt pacientët do të kenë mundësi të kenë qasje te kanabisi për shërim, njofton TetovaSot. Këtë e parasheh propozim-ligji i cili përgatitet nga Ministria e Shëndetësisë qëllimi i të cilit është përdorimi legal i prodhimeve të kanabisit për qëllime mjekësore. Ky bar do të jepet me recept dhe do ta

shkruaj mjek specialit.



Mbyllen shkollat dhe kopshtet në Tetovë për shkak të ndotjes



Për shkak të koncentrimëve të larta të PM 10 grimcave të dëmshme në ajër, që disa herë e tejkalojnë nivelin e lejuar për një kohë të gjatë, Komuna e Tetovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe

Shkencës sot mori vendim për ndërprerje të mësimit deri në fund të gjysëmvetorit të parë në shkollat fillore



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



dhe të mesme dhe në kopshtet në Tetovë.

Këtë e deklaroi kryetarja e Komunës së Tetovës, sot në konferencën për shtyp pas takimit me drejtorët e të gjitha institucioneve arsimore në qytet.

"Koshientë për seriozitetin e gjendjeve, si dhe implikimet negative për ndotjen e ajrit për shëndetin e nxënësve, kjo masë hyn në fuqi prej sot, e do të zgjasë deri në përfundim të gjysmëvjetorit të parë shkollor", deklaroi Arifi.

Arifi u përqendrua edhe në protestën e paralajmëruar për nesër, të cilën për shkak të ajrit të ndotur do ta organizojnë disa organizata joqeveritare.

"Protestat gjithmonë i kam konsideruar si dëshmi dhe vlerë të një shoqërie vitale demokratike, por ajo që është esenciale është se akumulimi i vullnetit qytetar duhet të adresohet atje ku është vendi, duke i ruajtur gjithmonë sinqeritetin dhe vullnetin e mirë të qytetarëve. Protesta është e drejtë absolute demokratike dhe duhet si e tillë të mbahet dhe të shprehet, por, mes të tjerash, duhet edhe të punohet që të ndryshojë gjendja me cilësinë e ajrit ambiental", tha Arifi.

Ajo theksoi se si komunë në kaudër të veprimit juridik dhe institucional ka ndërmarrë një sërë masash për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, siç është funksionimi i sistemit për parkim zonal nëpër qendër të qytetit për zvogëlimin e rrëmujës në trafik, formimi i ndërmarrjes publike për trafik rrugor për shkak të së cilës është kërkuar nga Qeveria që komunës t'i japë 8 autobusë, spërkatje të rrugëve tashmë një muaj me kalcium magnezium acetat, kufizim të kohës për ngarkim-shkarkim të mallrave në periudhën prej orës 19 deri në orën 8 të ditës vijuese, për çka tashmë janë gjobitur njëzet ndërmarrje që nuk e kanë respektuar këtë.

Ajo shtoi edhe se është rritur numri i inspektorëve për mjedis jetësor nga dy në 11, është hapur linjë telefonike falas dhe ueb-portal për denoncim të sjelljes joadekuate të individëve dhe institucioneve ndaj ambientit, është vendosur rorientim i kamionëve të transportit të rëndë, të cilët Tetovën nuk e kanë destinacion përfundimtar nëpër rrugët alternative.

Arifi paralajmëroi se nëse ka nevojë edhe konform vendimeve të Këshillit të Komunës do të mendojnë edhe për vendosjen e masave shtesë më rigoroze për kufizimin e qarkullimit nëpër qendër të Tetovës.